



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА
ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT
STATE AUDIT OFFICE

ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT

- Njoftim për mediumet-

Shkup, 25.01.2023

Mungon sistem për shfrytëzimin e fondeve të BE-së për bashkëfinancimin e projekteve strategjike

Shfrytëzimi i mjeteve nëpërmjet Kornizës së Investimeve në Ballkanin Perëndimor (WBIF) të imponon detyrim që të dizajnohet sistemi më efikas për shfrytëzimin dhe marrjen e tyre

Enti Shtetëror i Revizionit kreu revizionin e suksesit me temë „*Procesi i fitimit dhe shfrytëzimit të mjeteve nga Korniza e Investimeve në Ballkanin Perëndimor (WBIF)*” në pajtim me Programin Vjetor të Punës me qëllim që ti përgjigjet pyetjes: *“A është dizajnuar sistemi efikas dhe efektiv për marrjen e mjeteve nga Instrumenti WBIF - Korniza e Investimeve në Ballkanin Perëndimor?”*

Qëllimi i Kornizës së Investimeve në Ballkanin Perëndimor (WBIF) është të rrisë kapacitetin e rajonit të Ballkanit Perëndimor për financimin e **infrastrukturës kyçe dhe investimeve prioritare** në pajtim me prioritetet për aderim dhe për të përmisuar koordinimin e përgjithshëm të ndihmës.

Për shkak të rolit të WBIF-së në IPA III në drejtim të absorbimit më të madh të mjeteve dhe për shkak të rëndësisë së ndihmës financiare të BE-së për Ballkanin Perëndimor të përcaktuar në Planin e Investimeve Ekonomike të BE-së për Ballkanin Perëndimor në vlerë **prej 9 miliard euro**, për projekte rajonale në vlerë **prej 20 miliard euro**, imponohet detyrimi të **dizajnohet** sistem më efikas dhe ekonomik për shfrytëzimin dhe marrjen e mjeteve nëpërmjet WBIF me kornizë juridike kombëtare në të cilën **qartë** rregullohet roli dhe kompetencat e të gjitha institucioneve të cilët janë përfshirë në proces.

Ndryshimi i politikës së financimit të projekteve me mjete buxhetore ose partneritet publik-privat, shkakton **humbjen** e mjeteve të grantit të aprovuar për ndihmë teknike dhe **pamundëson** bashkëfinancimin e projekteve me grante investuese nëpërmjet WBIF, gjë që **ndikon** në zbatimin efektiv të këtij instrumenti.

Bashkimi Evropian ndanë mjete për bashkëfinancim të projekteve infrastrukturore **për ndihmë teknike dhe granteve investuese** me publikimin e thirrjeve për aplikim. Sipas të dhënave të marra nga Sekretariati për Çështje Evropiane (SEP), të publikuara në faqen e internetit të WBIF, WBIF financoi projekte në Republikën e Maqedonisë së Veriut në vlerë totale prej **2,6 miliard euro**, për të cilat janë aprovuar **43 grante** në vlerë prej **421,8 milion euro**, gjegjësisht **391,9 milion euro** për grante investuese dhe **29,9 milion euro** për ndihmë teknike.

Në fund të **korrikut të vitit 2022**, në kuadër të **thirrjes së gjashtë investuese** në të cilën janë aprovuar **576 milion euro** nga Bashkimi Evropian për projektet e para për zbatimin e Planit Investues dhe Ekonomik të BE-së për Ballkanin Perëndimor, për Republikën e Maqedonisë së Veriut janë aprovuar **230 milion euro**, gjegjësisht **40%** nga totali i mjeteve.

Republika e Maqedonisë së Veriut nga viti 2009 deri më vitin 2022 ka aplikuar **në njëzet e tetë (28) thirrje për ndihmë teknike dhe shtatë (7) thirrje për grante investuese, prej të cilave janë** aprovuar grante investuese në vlerë prej **385 milion euro për dymbëdhjetë (12) projekte**. Për pjesën më të madhe të projekteve **nuk është filluar** investimi, **nuk janë lidhur kontratat** për grantet dhe **ka ngecje** në raport me dinamikën e planifikuar të realizimit.

Nëse nuk përfundojnë projektet dhe nuk janë në përdorim në afatin e paraparë **ekziston rreziku për humbjen e mjeteve grant** ose krijimi i **detyrimit për kthimin e grantit investues**.

Sistemi për marrjen e mjeteve përmes WBIF-së **nuk ka përkufizim të qartë të kornizës juridike dhe institucionale** me trupat dhe institucionet kompetente, kornizë juridike kombëtare përkatëse për shfrytëzimin e WBIF-së, si dhe lista e vetme e projekteve nuk jep pasqyrë të qartë juridike për projektet më të rëndësishme dhe „të pjekura” strategjike në kushtet e hapësirës fiskale të kufizuar për huamarrje.

Në vitin 2015 është formuar **Komiteti Investues Kombëtar dhe Lista e vetme e projekteve** me çka Republika e Maqedonisë së Veriut si vend shfrytëzues i plotëson kushtet për pjesëmarrje në thirrjet për grantet investuese.

Me revizionin është konstatuar se për shkak të kushteve për aplikimin e projekteve të cilat financohen me hua nga kreditorët oficial, **nuk bëhet** prioritizimi i projekteve me të cilat aplikohet.

Përkatësisht, Komiteti Investues Kombëtar është përgjegjës për formimin e listës së vetme të projekteve, por **nuk ka kompetenca të kryej** përzgjedhjen e projekteve për aplikimin e thirrjeve për fitimin e ndihmës teknike dhe grantit investues. Shfrytëzuesit përfundimtar parashtrojnë aplikacione individuale të cilat i miraton Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, para se të dorëzohen deri te Komisioni Evropian.

Republika e Maqedonisë së Veriut **ka aplikuar** me katër projekte investuese dhe **ka fituar mbështetjen** për të gjitha projekte, përkatësisht: **ndërtimin e Korridorit VIII lindor (faza e tretë)** në vlerë prej **155 milion euro**, **Impianti për trajtimin e ujërave të zeza në Shkup** në vlerë prej **70 milion euro** dhe **ndërtimin e centraleve fotovoltaike Oslomej I, Oslomej II dhe Manastir** në vlerë prej **6,7 milion euro**.

Kontaktet për shtyp:

Albiona Mustafa Muhaxhiri +389 72228 203 albiona.mustafa@dzr.gov.mk

Mijallçe Durgutov +389 70 358 486 mijalce.durgutov@dzr.gov.mk

Martin Duvnjak +389 75 268 517 martin.duvnjak@dzr.gov.mk